

V E N D I M
Nr.124, datë 15.3.1994

PËR KRITERET E DHËNIES SE NDIHMËS EKONOMIKE NË FAMILJET BUJQËSORE

Në zbatim të ligjit nr.771O, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”, me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kanë të drejtë të pretendojnë për ndihmë ekonomike vetëm familjet bujqësore që në bazë të dokumentit përkatës kanë tokë në pronësi ose në përdorim.

Familjet e përcaktuara në paragrafin e parë trajtohen me ndihmë ekonomike të pjesshme, pavarësisht nga sasia e tokës në pronësi ose në përdorim, deri në 6 muaj nga data e marrjes së tokës. Pas këtij afati për familjet pretenduese zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”.

2. Ky vendim ka efekt edhe për familjet e ish-NB-ve.

3. Përfundimisht, për muajt janar dhe shkurt të vitit 1994, familjet e ish-punonjësve të NB-ve do të trajtohen sipas këtij vendimi, kurse familjet e ish-punonjësve të NB-ve që nuk u trajtuan për muajin dhjetor të vitit 1993 sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.275, datë 12.6.1993, do të trajtohen sipas këtij vendimi edhe për atë periudhë.

4. Ngarkohen Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 mars 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi